



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600020/5

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandohet ushtrimi kontrollit mbi veprimtarinë e kryer prej Përmbaruesit Gjyqësor Privat, z. Julian Prifti, për zbatimin e legjislacioni, si dhe gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetasit A.V.*

Drejtuar : **Ylli Manjani**
Ministër i Drejtësisë

TIRANE

Për dijëni : **A.V.**
Adresa: Adresa : Rruga e "Kavajës", Condor Centër,
Kulla E, Hyrja 19, Kati 8,

TIRANE

I nderuar z.Ministër,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim çështjen e prezantuar prej shtetasit A.V., me anë të së cilës kërkohet ndërhyrja e Avokatit të Popullit për mundësimin e rivendosjes në vend të së drejtës për zhvillimin e një procesit të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë Nr.1169, datë 15.07.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Vlorë, me Vendimin nr. 78, datë 05.02.2013, për të cilin është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit nr. 509, datë 08.05.2013, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, me objekt midis të tjerave :

"Detyrimin e palës së paditur "ERAG" Sh.p.k., Fier, t'i paguaj paditësit A.V. shumën gjithësej prej 930600 Lekë, nga e cila shuma prej 900000 Lekë përfaqëson vlerën e qerasë prej 180000 Lekë në muaj për periudhën Nëntor 2010-Mars 2011, ndërsa shuma prej 30600 Lekë inflacionin për Vitin 2010, si shlyerje e detyrimit kontraktor të rrjedhur nga kontrata e qirasë nr.3571 rep, nr.1774 kol, datë 17.10.2007, lidhur midis tyre. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur në masën e pranuar të padisë".

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit si dhe pretendimeve të tij për cënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të lartpërmendur, dyshojmë se, ka ndodhur shkelja e së drejtës së

pretenduar prej ankuesit A.V., prej Shoqërisë “Prestige Bailiff Services”, Sh.p.k., Përmbaruesi Gjyqësor i çështjes z.Julian Prifti.

Referuar aktit të venë në dispozicion nga ana e ankuesit, rezulton se, Përmbaruesi Gjyqësor Privat, z. Julian Prifti, me Vendimin nr. 2687, datë 08.09.2014, ka vendosur për ; *“Pezullimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr. 509, datë 08.05.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier”*, për shkak të mosgjethjes së pasurisë së sekuestrueshme në emër të debitorit, konform parashikimit të kryer në nenin 615/d të K.Pr.C.

Në pjesën përshkruese të Vendimit nr. 2687, datë 08.09.2014, të Përmbaruesit Gjyqësor Privat, z. Julian Prifti, konstatojmë se, janë kryer disa veprime për verifikimin e pasurive të mundshme në pronësi të palës debitore, pranë disa prej organeve shtetëror, si ; Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, datë 10.05.2013; Bashkisë, Fier, datë 17.07.2013; Bashkisë, Tiranë, datë 17.07.2013; ZVRPP, Tiranë, datë 12.06.2013.

Veprimet përbarimore të kryera, i konsiderojmë të paplota e për rrjedhojë të parregullta, për shkak se, nuk rezulton të jenë kryer veprime përbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të lartpërmendur pranë bankave të nivelit të dytë apo Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, ZVRPP, Fier, ku dhe ka selinë pala debitore.

Referuar faqes zyrtare elektronike të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, rezulton se, mbi kuotat/aksionet e palës debitore, Shoqëria “E” Sh.p.k., është vendosur masë sekuestroje prej Shoqërisë Përbarimore “Bailiff Services Albania” Sh.p.k. në zbatim të një tjetër tituli ekzekutiv në ngakim të debitorit “E” Sh.p.k.

Përmbaruesi Gjyqësor Privat, z. Julian Prifti, me rastin e mosdorëzimit të detyrimit në të holla prej palës debitore Shoqëria “E” Sh.p.k., në afatin ligjor për zbatimin vullnetar të detyrimit, mund edhe duhet të vendos masën e sekuestrës mbi kuotat/aksionet e palës debitore, sikurse ka ndodhur në rastin e lartpërmendur. Gjithashtu, Përmbaruesi Gjyqësor Privat, z. Julian Prifti, mund edhe duhet t’i drejtohet bankave të nivelit të dytë të cilat disponojnë llogari të palës debitore për dhënie informacioni rreth gjendjes në të holla si dhe sekuestrimit të llogarisë(-ve) të debitorit.

Konstatohet se, Përmbaruesi Gjyqësor Privat, z. Julian Prifti, nuk i ka kryer këto veprime përbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë Nr.1169, datë 15.07.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, qëndrim i cili nuk vjen në përputhje me parimin e profesionalizmit apo detyrën e zbatimit me përpikmëri të dispozitave të K.Pr.C. dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, si dhe kryerjen e të nevojshme që synojnë realizimin e së drejtës të kërkuesit dhe mbrojtjen e interesave të tij të ligjshme.

Moskryerja e veprimeve përbarimore në mënyrë të rregullt për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, pengon materializimin e asaj të drejte të fituar prej subjektit në rrugë gjyqësore dhe garantuar nga neni 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se : *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*. Fakti që deri më sot nuk është bërë i mundur ekzekutimi i Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.1169, datë 15.07.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, për shkak të moskryerjes në mënyrë të

rregullt prej Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Privat, të veprimeve përmbarrimore për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor në fjalë, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, përbën cënim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszekutimit të vendimit të formës së prerë në fjalë në një afat të arsyeshëm, nga data e vënies në ekzekutim pranë Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Privat.

Prezantimi i kësaj situate prej gjyqfituesit A.V. në Gjykatën Kushtetuese, passjell në referim të nenit 131/f dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konstatimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e moszekutimit të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë të formës së prerë Nr.1169, datë 15.07.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier”.

Për një zgjidhje efektive të kësaj çështjeje, dhe si organ përgjegjës kontrolli, neni 10/b i Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat”, të ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:

REKOMANDOJMË

Ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë e kryer prej Përmbarruesit Gjyqësor Privat, Julian Prifti, për zbatimin e legjislacioni, si dhe gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetasit A.V.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë ;

Kopje të Vendimit nr.2687, datë 08.09.2014, të Përmbarruesit Gjyqësor Privat, z.Julian Prifti.

Kopje të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë Nr.1169, datë 15.07.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier.

Kopje të Vendimit, Urdhërit të Ekzekutimit nr. 509, datë 08.05.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**